



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2020:138757

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06102774

**C.nr. 2157/24.**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil**, me gjyqtarin Migjen Kastrati, në çështjen juridike të paditësit, H.P nga Prizreni, të cilin e përfaqësojnë Durim Osmani dhe Feim Alaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurve Q. P dhe T.P, të dy nga Peja, rr. ‘Gj.F nr....., për bazën juridike, kompensim i dëmit, vlera e kontestit 3,000.000.00€, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, jashtë seancës gjyqësore, me datën 29.08.2024, bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. HAPET KONFLIKTI I KOMPETENCËS** në mes të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm Civil dhe Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Civil, për të vendosur lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Civil, C.nr. 1504/20 i datës 03.04.2024, i plotfuqishëm me datën, 01.05.2024.

**II.** Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës, lënda i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

**A r s y e t i m**

Paditësi, përmes të autorizuarve të tij me datën 20.10.2020 ka parashtruar padi, kundër të paditurve, pranë Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Civil, për kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 3,000.000.00 €. Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Civil, ka marrë aktvendimin C.nr. 1504/20 me datën 03.04.2024, i plotfuqishëm me datën 01.05.2024 dhe është shpallur inkompetente në pikëpamje territoriale për të vendosur në këtë çështje juridike. Ndërsa lënda është bartur në Gjykatën Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm Civil.

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm Civil, pasi i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, konstaton se Gjykata Themelore në Prizren me aktvendimin e saj C.nr. 1504/20 me datën 03.04.2024 i plotfuqishëm me datën 01.05.2024 me të cilin është shpallur inkompetente në pikëpamje territoriale dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda me shkresat e saj është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Pejë.

Mirëpo me dispozitën e nenit 22 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore shprehimisht është përcaktuar se ‘’ Gjykata mund të shpallet jokompetente në pikëpamje territoriale vetëm sipas prapësimit të palës së paditur të parashtruar me anë të përgjegjës në padi’’, ndërsa në rastin konkret Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm Civil, është shpallur inkompetente në pikëpamje lëndore pa prapësimin e palëve të paditura, respektivisht nuk është dërguar aktvendimi për përgjigje në padi. Ndërsa me dispozitën e nenit 22.3 të LPK-së, është përcaktuar se: ‘’ Gjykata mund të shpallet inkompetente në pikëpamje territoriale, sipas detyrës zyrtare, vetëm kur ekziston kompetenca territoriale ekskluzive e ndonjë gjykate tjetër, por me së voni deri në momentin e paraqitjes së përgjigjes në padi.

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm Civil, duke u bazuar në dispozitën e nenit 24 të LPK-së, e hap konfliktin e kompetencës në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që vlerëson se në rastin konkret, Gjykata Themelore në Prizren është shpallur inkompetente në pikëpamje territoriale në kundërshtim me dispozitën e nenit 22 të LPK-së, respektivisht pa u plotësuar këto kushte ligjore të cilat janë përcaktuar me këtë dispozitë. Ndërsa me nenin 25 të LPK-së, është e paraparë se për konfliktin lidhur me kompetencën midis gjykatave të llojit të njëjtë, e zgjidhë gjykata që është më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt. Ndërsa ligjin me Nr. 06/L-054 për Gjykata, respektivisht me nenin 22 par. 1 pika 1.2 është përcaktuar kompetenca e Gjykatës se Apelit që të vendos për konfliktin e juridiksionit ndërmjet Gjykatave Themelore.

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore nga neni 22.1, 24, 25.1, 387 pika (u) dhe 392 pika (b), e lidhur me neni 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2020:138757, C.nr.2157/24 i dt. 29.08.2024.**

**Gj y q t a r i**  
**Migjen Kastrati**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.